VENDIM
Nr. 167, datë 28.6.2022

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "SALILLARI ENERGY TRADE" SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa "d", 5, pika 1, germa "d", dhe nenit 13 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.6.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 935/5 prot., datë 23.6.2022, "Mbi licencimin e shoqërisë "Salillari Energy Trade" sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 90, datë 28.4.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Salillari Energy Trade" sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
- ERE, me shkresën nr. 70/15 prot., datë 29.4.2022, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 16.5.2022), nuk rezultoi të kishte të tilla.
- Me shkresën nr. 469/2 prot., datë 6.5.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.
- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria "Salillari Energy Trade" sh.p.k., me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 469/5 prot., datë 20.5.2022 dhe nr. 495/6 prot., datë 24.5.2022, ka përcjellë në ERE dokumentacionin dhe informacionin shtesë.
- Në kuptim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 149, datë 10.6.2022, shoqëria "Salillari Energy Trade" sh.p.k. duhej të depozitonte në ERE, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja dijeni e vendimit, vërtetimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe vërtetimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sikurse përcaktohet në nenin 9, pika 2, germa "d", të rregullores së sipërcituar.
- Brenda afatit të përcaktuar me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 470/2 prot., datë 20.6.2022, shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t'u pajisur me licencë për furnizimin e energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të aneksit A, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.
- Në zbatim të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, shoqëria ka plotësuar dokumentacionin, si vijon:
  - formati dhe dokumentacioni për aplikim – neni 9, pika 1, germat "a", "b" dhe "c";
  - dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor – neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c" dhe "e";
  - dokumentacioni financiar dhe fiskal - neni 9, pika 3, germat "a", "b", "c" dhe "d";
  - dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike – neni 9, pika 4.7, germat "a", "b", "c" "d", "e", "f", "g", "h" dhe "i".
- Për sa u përket kërkesave të nenit 9, pika 2, germa "d", lind nevoja që shoqëria të informojë ERE-n çdo tre muaj, në lidhje me ecurinë e procesit gjyqësor.

- Për sa u përket kërkesave të nenit 9, pika 4.7, germa "e", referuar marrëveshjes së përcjellë nga shoqëria "Salillari Energy Trade" sh.p.k., të lidhur me shoqërinë mëmë, ku përcaktohet që kjo e fundit merr përsipër që të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme, që me stafin dhe mjetet e saj të instalojë sistemin IT në fushën e energjisë për këtë shoqëri, vlerësohet që t'i lihet kusht shoqërisë që përpara fillimit të operimit të veprimtarisë së licencuar të depozitojë në ERE informacion mbi instalimin konkret të këtij sistemi.

- Për sa u përket kërkesave të nenit 9, pika 4.7, germa "g", që ka të bëjë me dokumentacionin që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t'u ofrohen klientëve, vlerësohet që t'i lihet kusht shoqërisë depozitimi jo më vonë se data 1.3.2023, të kontratës së rinovuar së disponimit të zyrave për shërbimet që do t'u ofrohen klientëve (data e fundit e vlefshmërisë së saj).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Salillari Energy Trade" sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Përpara fillimit të operimit të veprimtarisë së licencuar, shoqëria të informojë ERE-n mbi implementimin konkret të sistemit IT.

3. Shoqëria "Salillari Energy Trade" sh.p.k. të informojë ERE-n, çdo tre muaj, në lidhje me ecurinë e procesit gjyqësor, deri në përfundim të këtij procesi.

4. Shoqëria të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar për disponimin e zyrave, brenda datës 1.3.2023.

5. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti